



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:270900

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06434343

P.nr.333/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË -DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me bashkëpunëtorin profesional Launor Gerbeshi, në çështjen penale kundër të pandehurit H. B., për shkak të veprës penale "Kanosja" nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4471/2024, të datës 30.09.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, më datë 25.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr. 4471/2024 e datës 30.09.2024, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

H. B., nga i ati I. dhe e ëma K. e gjinisë H., i lindur më ... në P., me vendbanim në fshatin K. Komuna P., me numër personal ..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Sepse;

Me datë 27.08.2024, në fshatin K. Komuna e P., i pandehuri ka kanosur seriozisht të dëmtuarin N. B., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje të më hershme në lidhje me një pronë, i njëjti e kanos me fjalët "je ka më bënë presion në gjykatë dhe në polici dhe nuk ke për të shpëtuar pa të vrarë", me ç ka tek i dëmtuari është shfaqur ndjenja e frikës, ankthit dhe pasigurisë për jetë.

- me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPR të Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 181 të KPRK-së, si dhe të neneve 359, 364, 449, 462, 493 dhe 495 të KPP-së, të pandehurit;

I SHQIPTON

I. DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro, të cilën i pandehuri është i detyruar ta paguajë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën brenda afatit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë do të caktohet një (1) ditë burgim.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) Euro ndërsa në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

IV. I dëmtuari N. B. nga P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, sipas aktakuzës PP.II.nr. 4471/2024, të datës 30.09.2024, ka akuzuar të pandehurin H. B. për shkak të veprës penale "Kanosja" nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, dhe njëherit ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se nga kallëzimi penal ka prova të besueshme lidhur me bazueshmërinë e akuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas shqyrtimit paraprak të aktakuzës si dhe provave në të cilat mbështetet aktakuza, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara nga neni 493 par. 1 të KPP-së, andaj konform nenit 495 të KPP-së, vendosi të pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 493 par. 1 të KPP-së, është përcaktuar se për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkëngjitura në shkresat e lëndës dhe atë: kallëzimit penal me nr. 2024-AF-0884, deklarata e të dëmtuarit dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë janë prova të besueshme, mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri është kryerës i veprës penale "Kanosja" nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 495 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.333/2024, me dt. 25.10.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktgjykimi për dhënien Urdhrit Ndëshkimor, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim, në afat prej tetë (8) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit, kësaj gjykate.